



Memorandum

i nënshkruar prej Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH)
dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA),
të quajtura më tej *Palë*

Neni 1

Përcaktimi i *Palëve*

Palët në këtë memorandum janë:

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH), me qendër në Tiranë, sheshi *Fan Noli*, e përfaqësuar nga akad. Vasil S. Tole, Sekretar Shkencor;
2. Akademia e Studimeve Albanologjike (ASA), me qendër në Tiranë, sheshi *Nënë Tereza*, e përfaqësuar nga akad. Marenglen Verli, Rektor.

Neni 2

Qëllimi

Ky memorandum ka vlerën e një marrëveshjeje parimore dhe nënshkruhet me qëllim që *Palët* të garantojnë parimet themelore të bashkëpunimit, mbështetur në parime të gjithëpranuara dhe në interesa të përbashkët.

Neni 3

Raportet mes *Palëve*

Palët respektojnë njëra-tjetrën në vetëveprimin e tyre të rregulluar me ligje-kuadër, gjegjësisht me akte nënligjore organike. Autonomia akademike dhe universitare është parim themelor rregullues në bashkëpunimin e tyre.

Neni 4

Zotime

Palët zotohen që, duke ruajtur pavarësinë e njëra-tjetrës, të konsiderojnë vlera të ndërsjellta përvojën e bashkëpunimit shkencor në kuadër të organizimeve të mëparshme dhe të bashkojnë energjitë dhe vullnetet e tyre për t'i ruajtur e zhvilluar ato në nisma të përbashkëta mbështetur këtij memorandumit.

Neni 5

Bashkëpunime funksionale

ASHSH, si bartëse e vetme e statusit të përfaqësimit shtetëror në organizata dhe shoqata ndërkombëtare e rajonale shkencore, si AIESEE, ALE etj., *par tradition*, njeh ASA dhe institutet e saj si *palë prioritare*.

Palët ushtrojnë të drejtën e përfaqësimit për të përçuar mendimin e njëra-tjetrës në institucionet ndërkombëtare ku janë të anëtarësuara a të asociuara, si dhe në ato me të cilat kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

Palët informojnë njëra-tjetrën për marrëveshjet dy ose shumëpalëshe me interes të ndërsjelltë.

Neni 6

Projekte kombëtare e ndërkombëtare

Për realizimin e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare *Palët* i referohen parimit të paritetit.

Për realizimin e projekteve shkencore kombëtare që kanë vijimësi kronologjike, si *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, *Atlasi Gjuhësor i Shqipes*, etj., ASA konfirmon si *palë prioritare* bashkëpunuese ASHSH. Hapat në këtë bashkëpunim përcaktohen rast pas rasti dhe janë çështje dypalëshe.

Neni 7

Këshilli NdërkademiK për Gjuhën Shqipe

Palët konsiderojnë se trashëgimia shkencore në kuadër të Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe është një çështje e përbashkët e tyre.

Neni 8

Përparësi

Për fushat prioritare studimore të albanologjisë, si identiteti i shqiptarëve, njësia e shqipes në përdorimin zyrtar dhe çështje të tjera të ngjashme, Palët bashkëpunojnë pa diskutime paraprake, përveç aspekteve organizative.

Palët ofrojnë bashkëpunim për organizimin e konkursit shkencor për çmimet kombëtare vjetore.

Me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në protokolle të bashkëpunimi me të tretë, nënshkruar para këtij memorandumi, palët i njohin njëra-tjetrës të drejtën e të ftuarit të parë në veprimtaritë kryesore shkencore të çdo viti.

Neni 9

Përjashtimet

Palët bashkohen në vullnetin për të zbatuar Kodin evropian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor dhe që të mos inkurajojnë e përurojnë studimet me karakter parashkencor dhe autorët e tyre.

Neni 10

Ndërveprimi

Palët caktojnë një koordinator për bashkëpunimin shkencor në kuadër të këtij memorandumi.

Neni 11

Shkëmbimet

Palët bashkëpunojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për shkëmbimin në mënyrë të barabartë dhe të pakushtëzuar të informacionit shkencor, të periodikëve që botojnë, të studimeve dhe monografive;

Palët i njohin njëra-tjetrës status të barabartë për pranimin për botim të kontributeve shkencore të kërkuesve të tyre;

Palët shkëmbejnë ekspertiza dhe mbikëqyrje të përbashkëta të veprimtarisë shkencore në ekspedita dhe në botime.

Neni 12

Kohëzgjatja

Ky memorandum ka fuqi veprimi pa kohë të përcaktuar, me përjashtim të rasteve kur ndërprerja e tij vjen për shkaqe juridike të paparapara dhe kur:

- Ndryshon statusi ligjor i institucioneve dhe ky ndryshim prek funksionet themelore të tyre, me efekt në Palën tjetër;*
- Njëra nga Palët shpreh me shkrim dhe në mënyrë juridikisht të arsyetuar shqetësimin për cenimin e interesave bazalë të saj për shkak rrjedhøjave të paparashikuara në procesin e plotësimit të kushteve të këtij memorandum;*
- Me anë të një deklarate publike për mungesë vullneti.*

Neni 13

Zbatueshmëria

Ky memorandum bëhet i zbatueshëm përmes nënshkrimit të protokolleve të bashkëpunimit me afat jo më pak se pesëvjeçar.

Neni 14

Apelimi

Ky memorandum është çështje dypalëshe, në kuadër të legjislacionit shqiptar.

Palët nuk kërkojnë apelim në ndonjë gjykatë apo në ndonjë instancë tjetër për paqartësitë e mundshme në lidhje me këtë memorandum.

Mosmarrëveshjet midis Palëve zgjidhen me bisedime.

Në rast të mosarritjes së dakordësisë për një periudhë dyvjeçare për çështjet e diskutueshme, ky memorandum konsiderohet pa vlerë ligjore e angazhuese.

Neni 15
Të fundme

Ky memorandum nënshkruhet në dy kopje, të dyja në gjuhën shqipe, një për secilën *Palë*, me vlerë të barabartë.

Nënshkruar:

Për Akademinë e Studimeve
Albanologjike

Akad. Marenglen Verli
Rektor



Për Akademinë e Shkencave të
Shqipërisë

Akad. Vasil S. Tole
Sekretar Shkencor



Tiranë, më 09 10 2018

Prot. 377